Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno 21-06-2021
Nr.i organit / Org.broj: 01-060/01-458

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

# FTESË

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **-V-**, të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën: **29.06.2021, (e Martë),** duke filluar në ora 10;00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit, në Shtëpinë e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

## Rend dite

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e KK-së**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën afatmesme buxhetore (KAB), të Komunës së Vitisë 2022-2024.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësim të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbështetje financiare për shpenzimet e strehimores Liria Gjilan për një periudhe trevjeçare 2021-2022-2023.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2022.**

**Viti, më 21.06.2021**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Naim Pira**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROCESVERBAL

## I MBLEDHJES SË KATËRT TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 28.04.2021 (e Mërkure) në Shtëpinë e Kulturës "Gursel dhe Bajram Sylejmani", duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, Kryetari z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahimi, Zekirja Zuka, Bajram Sokoli, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Lindita Demelezi, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, mjetet elektronike, zyrat e kryetarit.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e katër të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë. Më lejoni të përshëndes nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Zyra Ligjore e MAPL-së naj ka konfirmu ligjshmërinë e disa akteve që i kemi miratu në seancën e kalume. Rregulloren për këshillat e fshatrave e ka kthy në rishqyrtim. Sigurish ne seancën e radhës e sjellim.

**Sekretaria:** Kryesuesi i njoftoj me gjendjen aktuale me Covid 19 në komunën tonë.

**Kryesuesi, z. Naim Pira:** Tani kalojmë tek pyetjet dhe përgjigjet, fjala është për ju.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam dy pyetje. E para ka të bëjë lidhur me tenderin, shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes se objekteve komunale. Ky tender jepet për tri vite. Këtë vit dhe është hera e parë që ky tender jepet për tri vite dhe me vlerë prej 570 mije euro e fiton kompania e njëjta e cila e kishte edhe dy vitet me parë, apo konzercium i kompanive të lidhura shpk. "Krasniqi", shpk. "Beni dhe Aroma plus". Shtrohet pyetja, ku në vitet paraprake për një vit shuma ishte 115 mijë euro, e kur ta llogaritësh për tre vite del që është 345 mijë, ndërsa kontrata tani që është bë për tre vite është 570 mije euro, që është 225 mije euro me e shtrenjtë dhe pse për tri vite çka ka ndryshu në paramasë, për shkak të çmimit. Për çfarë arsye jepet tani për tri vite, kur dijet që sivjet është ndoshta edhe viti i fundit i kësaj qeverisje komunale nga ana e juaj. Dhe pyetja tjetër, ka të bej me një informacion që ne si opozitë e kemi për sekretarët e shkollave. Në shkollën teknike dhe ne gjimnaz, ne kemi informatën se vetëm janë te përcaktuar njerëzit, se kush do te vjen në ato vende te punës dhe tash hapen konkurse sa për sy e faqe. Emrat nuk po i ceku, po nëse doni ja japim edhe emrat se kush do të vjen sekretar shkolle.

**z.Nuredin Luftiu:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam pyetje për nënkryetarin lidhur me nënshkrimin e marrëveshjes për 12 fshatrat me ujësjellës. A përfshihen marrëveshja, që në ujin e Letnices apo në ujësjellësin

që ka ekzistu me herët. Dhe pyetja tjetër për drejtorin e Shërbimeve Publike, nëse ke mundësi me dhënë sqarim: pse nuk po rregullohen këto shaknat e kanalizimit prej "Lindit" e deri tek samaforat? Ka gogjo shumë probleme në komunikacion. Edhe një pyetje për drejtoreshën e Katastrit, kemi bë gati që tri ose katër vite disa kërkesa për kalimin e pronës prej AKP-së në pronë publike, për shfrytëzimin e disa rrugëve në fshatin Skifteraj dhe ende nuk kemi përgjigje. Nëse është e mundshme me naj bë një përgjigje me shkrim: pse nuk po na realizohet?

**z.Bekim Azizi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kemi pas një kërkesë, është senaca e gjashtë për shërbime të Caritsasit. Drejtoresh, hala nuk i ke pru ato shënime, do t'i përsëris rregullisht. Kemi pas sot edhe Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport marrëveshjen me stadiumin që e kemi diskutu ne seancën e kalume nuk e keni sjellë, besoj që herën tjetër e sjellin. Kisha një pyetje për drejtorin e financave: a ki ndonjë shënim, sa vendime të gjykatave janë fitu nga mësimdhënësit dhe sa është dëmi që i bëhet buxhetit komunal, edhe vetëm i pritni që të ju merren me zor ato mjete, apo si do te veproni, sepse e di që është numri i madh i mësimdhënësve që e kanë fitu kontestin gjyqësor lidhur me kontratën kolektive. Tek Drejtoria e Shërbimeve Publike. Drejtor, punëtorët e pastrimit dy rroga nuk i kanë marr, i përcjellni e i mbikëqyrni kompaninë, po ata janë punëtor që punojnë çdo ditë në rrugë. Je në kontakt me ta, kanë bë kërkesë ata rregullisht tek ti, ju presion i bëni zakonisht me punu, po kur të kërkojnë për rroga, ju thoni keni punë me kompaninë, mirëpo bëni presion ju kompanisë, sepse është gjynah prej atyre punëtorëve. Isha lidh tani të një kontratë që është dhënë sivjet dhe në kuadër të kësaj kontrate që e kemi bisedu shpeshherë, format që manipulohet ose që përgatiten kontratat të jepen kompanive të caktuara. Nuk është një kontratë e madhe po po flas për vlerat se qysh e përgatitni kontratat dhe ju kisha bë thirrje ata që e menaxhojnë këtë kontratë, sepse është njëvjeçare, le të kenë kujdes, sepse vetëm me përcjellin kontrata me rekuizita sportive për nevojat e shkollave, drejtorive. Po e lidh në disa, shumica e parametrave që janë këtu janë nga 0.50 cent ose 1 euro. Ato që nuk shfrytëzohen, ju kisha bë thirrje edhe ata që e mbikëqyrin kontratën, p.sh.: kemi topa të kualitetit të larte me vulë të FIFA-s, 30 euro; topa me kualitet të mesëm, 30 euro dhe vetëm topa të futbollit, 25 euro. Ju kisha kërku pasi që i keni te tre parametrat. Krejt merrni me kualitet të lartë, sepse janë me çmim të njëjtë, sepse edhe ne do ta përcjellim këtë kontratë deri në fund, do të kërkojmë shënime. Këtë buxhet duhet ky kuvend me e kontrollu, sepse ne e miratojmë këtë buxhet. Më përcjellni tani fanela të kompletuara për basketboll, asnjë nuk e merrni, a çmimi është 0.50 cent, ndërsa ku kemi fanellat për futboll, dresat kur të behet lojëra garat aty shkoni e merrni 25 euro. Keni shtylla të futbollit metalike, e keni 2 euro. Përdorni bre krejt shtyllat se janë prish ato të moçmet. Keni vlera, dyshek për gjimnastikë, 10 centimetra i trash, e keni 1 euro. Po kapni bre furnizoni krejt shkollat me dyshek për gjimnastikë, se jav ka dhanë mundësinë me tender me 1000 euro, çka kishe qetu nga 1 euro krejt shkollat, krejt nxanësat po mujshi me i furnizu me pajisje, veshje për lojërat sportive. Në këtë aspekt po kërkoj nga ju çka e mbikëqyrni kontratën, i keni shënimet, i keni çmimet, kërkoni qeto vlerat e vogla janë më të rëndësishme se sa këto tjerat. Furnizoni shkollat, furnizoni mësimdhënësit e edukatës fizike, nxënësit e edukatës fizike.

**z.Taulant Haxhiu:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë e kam një pyetje për nënkryetarin e komunës. Unë e pash që afër rrugës time janë vendos samaforat edhe ai u kanë hit i krejt Kosovës. Nuk jemi kundër semaforëve, po vetëm po du me ditë si përgjigje që ata samafora a janë ligjërisht të vendosur aty apo jo. Kam informacione që ato samafora nuk janë ligjërisht të vendosur aty ku i keni vendos ju tek rruga e Pozheranit. Zotëri Ramiçi, ti e dinë që në seancën e kalume unë të kamë thanë që për ato që ti kam kërku për urën, i kam kry procedurat, i kam dërgu në protokoll. Besoj që brenda 7 dite do të m'i sjellësh ato që i kam kërku. Nëse nuk vinë brenda 7 dite, atëherë vendin e di ku me shku.

**z.Remzi Salihu:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Drejtoresh, kam bë një kërkesë në seancën e kalume, nuk ma sjelltë regjistrin e pagave të punëtorëve të cilët paguhen nga Caritasi. Nëse e keni të gatshme ma sjellni dhe nëse nuk e keni të gatshme ma jepni një përgjigje pse, arsyen. Edhe kryesues puna e mikrofonave: çka është në pyetje?

**znj.Liridona Bislimi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Nënkryetar, duhna ta bëjë një pyetje rreth komisionit për emërtimin e rrugëve, që është formu me 27.05.2019. Që nga ajo ditë, asnjëherë nuk është thirr ky komision për të ja filluar punën. Unë kam bë një hulumtim nëpër komuna tjera, dhe realisht të gjitha komunat kanë fillu, duke e bë emërtimin e rrugëve. Tash kanë fillu edhe qytetarët, duke u ankuar tek ju dhe ju po i dërgoni tek komisioni, i cili realisht nuk është as pak funksional. Javën e kalume kam pasur një takim me një banor në fshatin Terpezë, i cili i ka mbledhur edhe nënshkrimet e banorëve dhe është i gatshëm për emërtimin e një rruge, por nuk kam ditë se çfarë përgjigje ti jap: pse nuk është duke u funksionalizu ky komision?, për me ja fillu punës taman ashtu siç duhet. Tregu i kafshëve në fshatin Drobesh ka mbetur peng që nga mandati i kaluar i juaji, tash përpos rrezikut që ju kanoset edhe blerësve po edhe tregtarëve e ato rrugë aty në fshatin Drobesh, ajo rruga ku banojnë lagjja "Dubova", është dëmtuar komplet me gropa, nuk është e shtrume me zhavar as me asfalt, për shkak kaminave të kafshëve që barten aty, dhe ata sinqerisht kanë tepër telashe. Pra, a keni ndonjë përgjigje se kur do të jetë funksional ajo parcela pjesa e tregut të kafshëve?

**z.Sejdi Emini:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe unë sot do t'i shtroj disa kërkesa të qytetarëve të komunës sonë, kërkesa që kane të bëjnë drejtpërdrejt me jetën e tyre. Po e filloj me një kërkesë, ku besoj që është shumë e arsyeshme dhe është e domosdoshme në qytetin e Vitisë, kërkesë që është e domosdoshëm te këtë shtylla ndriçuese natën aty ku ka zebra. Janë disa qytete, si: Gjilan, Ferizaj, Prishtinë, unë mendoj që edhe në Viti është e domosdoshme, është një kosto shumë e vogël. Shumë herë natën duke kalu makinat nuk po e dinë ku ka zebra, së paku nalt le ta këtë një shenj ndriçuese, që na sinjalizon që mos te rrezikohemi. Kërkesa e dytë është e banorëve të fshatit Lubishtë, në rrugën "Avdullah Emini", një rrugë e cila me herët ata kane kerku edhe asfalt, mirëpo asfalti nuk ju ka bë. Ata kërkojnë së paku ta kenë ndriçimin për shkaqe sigurie. Drejtoreshës së bujqësisë ju drejtohem me një kërkesë për fermerët. Sa fermer kanë arrit të sigurojnë farëra në këtë sezon të të mbjellave?, ku në Gjilan janë 402 fermer që e kane fitu këtë të drejtë: në Viti a keni bë diçka dhe çka keni bë. Një pyetje. Te ish banka nalt atje, NLB-ja, ajo pjesa brenda ishte tmerr, ishte e pa përshtatshme për ata banorë, ishte krejt në balt. Edhe kjo pjesa mbrapa tek posta, ato kioskat, baraka kane mbete të shëmtuara letë bhetet diqka edhe ne ate drejtim le të zbukurohet edhe ai vend sepse me te vërtet ka nevojë për zgjidhje. E kam pa një storie të kompanisë "Mediteran", ku me të vërtet është një kompani që ka tregu suksese të larta në komunën tonë dhe ka shumë punëtorë. Më herët kemi thanë dhe prapë po kërkojmë që atyre bizneseve poshtë të ju krijohen kushtet elementare për të zhvilluar biznesin e tyre; ndriçim, tretuar, kanalizim edhe të ju ofrohen kushte, sepse ata po na ofrojnë shërbime dhe po punësojnë mjaft shume punëtor, ku ne si kuvend, si qeveri, kemi obligim t'i kryejmë obligimet ndaj tyre. Edhe kanalizimi ne fshatin Goshicë, është kry shumë më herët, tri shtëpi kanë mbet pa u kyç në kanalizim. Sigurish e dini të gjithë, këtu shtëpia e Florim Limanit ka dy mundësi, ose në pjesën nga Goshica që bien shumë më gjatë ose në pjesën nga Gërmova. Drejtor i financave, sigurish edhe me herët jeni kanë me ju kriju kushte, sepse me te vërtet kanë mbet keq.

**z.Ekrem Abazi:** Përshëndetje te nderuar të pranishëm! Para një muaji bëna një kërkesë, që ingjinierat tonë të dalin në teren dhe ta shikojnë rrugën Skifteraj-Goden, sepse është dëmtu shumë. Nuk kam informata a kanë dal ingjinierat me e shiku apo jo. Pyetja tjetër, para katër pesë dite u shkru një memorandum mirëkuptimi ne mese kryetarit të komunës, CDI-së dhe ujësjellësit rajonal "Hidromorava", që 12 fshatra të furnizohen me ujë. A ka mundësi një informatë pak me te zgjeruar me naj dhënë, deri kur është afati që ata fshatra mu furnizu me ujë dhe nga e kanë burimin ato fshatra për mu furnizu me ujë?

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Për vendosjen e mikrofonave nëpër vende në sallë, ju kam thanë që do të kryhen për këtë seancë, ashtu na patën premtu, mirëpo kanë dal disa probleme teknike, të cilat në parallogaritje, në paramasë, nuk i kanë parapa ingjinierat. Tash operatori që e ka fitu tenderin pa atë problematik nuk po fillon, e menaxheri i kontratës e ka kërku një takim, e ta shohim çka po muj me bë për këtë çështje. Asnjëherë nuk kam qenë i interesuar me e vonu këtë çështje.

**z.Ibrahim Rama, drejtor i financave:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pyetjet që kane të bëjnë me drejtorin time, aq sa kame informata, është fjala për pyetjen e këshilltarit, z.Bekim Azizi, lidhur me pagesën e obligimeve të punëtorëve të arsimit, të cilët e kanë paditë në gjykatat përkatëse, lidhur me pagat jubilare dhe me shpenzimet tjera që kane të bëjnë me ushqim etj. Njoftimin zyrtar dje e kame marr nga Ministria e Financave, gjegjësisht nga drejtoria e thesarit kanë mbërri, janë bë obligimet e plotfuqishme të cilat pritet se shpejti të ekzekutohet nga departamenti i thesarit, kështu që vetëm jemi tu e prit momentin me bë ekzekutimin, e na njoftojnë neve në Drejtorinë për Financa në cilat fonde ti marrin këto mjete për me i pagu këto obligime. Diet kjo që këtë problematikë e kemi që shtatë vite, deri vitin 2018 qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka nda mjete për këto obligime që janë të parpame në kontratën kolektive prej viti 2018 e këndej kemi dhe nuk kemi asnjë problem në pagesat e tyre, kështu që këto obligime do të naj ndryshojnë planifikimin. Ju jeni pjesë e buxhetit, e keni votu buxhetin, edhe strukturën e brendshme të buxhetit, kështu që unë kame informacione që do të ekzekutohen së shpejti. Pyetja tjetër ishte për pagesën e punëtorëve që punojnë në Komunën e Vitisë, që nuk i kanë marr ende pagat. Unë edhe mbledhjen e kalume ju kamë than që ne mungese të punëtorit në drejtorin e financave i cili ka vdek, Rexhep Sinani, i cili ka qenë zotues i mjeteve, kemi pas probleme me zëvendësimin e tij dhe prej dje kemi fillu me i ekzekutu. Kemi bë një zëvendësim, kështu që, sot pagat ju dalin punëtorëve, kështu që kompania sot i merr mjetet, kështu që kompania besoj që shpejt ju kryen pagat. Një pyetje tjetër ishte nga Ekrem Abazi, lidhur me asfaltimin e rrugës Skifteraj – Stubell. Po, shqetësim me vend ka qenë, edhe na në bordin e drejtorëve, kryetari ka marr vendim dhe i ka udhëzu ingjinierat përkatës, që me dal në teren me vleresu këtë rrugë edhe me bë një raport të saktë lidhur me të gjitha problemet që kane të bëjnë me këtë rruga dhe besoj që së shpejti do të merren edhe masa vepruese. Pyetje tjetër ish, lidhur me marrëveshjen që e ka nënshkrua kryetari, që ka të bëjë me rregullimin e ujësjellësve në nivel të territorit të komunës së Vitisë, është fjala për 14 ujësjellës. Pjesa dërmuese e këtyre janë ujësjellësit që kane të bëjnë me rehabilitimin, që janë ujësjellës ekzistues dhe afati i fundit që duhet të kryhet ky veprim nga CDI-ja dhe "Hidromorava" është 30 gushti i këtij viti. D.m.th deri me këtë datë duhet në plotni kjo marrëveshje të ekzekutohet edhe ne përmes kuvendit komunal besoj që kemi me i siguru mjetet me e pagu këtë participim.

**z.Nexhmedin Jakupi, drejtor i shërbimeve publike:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ishte një pyetje e nga Jakupi rreth mirëmbajtjes së vlerës së kontratës, mirëmbajtjes komunale arsimore dhe shëndetësore. E përmendi një shifër, unë e kam vlerën e kësaj kontrate. Vitin e kaluar 2020 ka qenë, 100 e 59 mije e 0.63 euro, Këto janë kontrata kornizë, këto mundeni me pas qasje edhe ju e ndërsa këtë vit është kontrata e re, është e vërtet kontrata trevjeçare bazë kërkesën që kemi bë dhe kemi vlerësua, se vazhdimisht kemi pas probleme në momente të caktuara kur kemi pas ankesa, është dash me ju vazhdu kontrata qati operatori pas skadimit të kontratës dhe këtu auditorët e jashtëm gjithmonë na kanë dhënë vërejtje edhe ne këtë moment e kemi rastin e njëjtë me projektin, mirëmbajtja e hapësirave publike, është shpall tenderi para dy muajve, është anku një kompani dhe tani procedurat, lënda ka shku në organin shqyrtues të prokurimit në Prishtinë, e tash ndodh qaj operator mos me pranu me i kry shërbimet pas përfundimit të kontratës dhe çka duhet të kishim bë ne, e për këtë dashta me e arsyetu, që në të ardhme me e parapa dy ose tre vjeçare kontratat për shërbime. U bë edhe një pyetje për posetat në qytet, tani me përmasimin e kohës do të merrmi me rivitalizimin e rrugëve, ku janë të dëmtuara po edhe posetat do t'i bëjmë zgjidhje.

**znj.Hanife Januzi, drejtoresh e shëndetësisë:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Për pyetjen e Bekimit, si zakonisht përgjigja është e njëjtë, po ti kisha unë në zyrë ato që i kërkon ti, do t'i sjelli po nuk i kamë unë. Ato i ka Karitasi. Profesor Remzi, listën e pagave për Karitas, marrëveshje që e kemi bë me Karitasin për stafin mjekësor, është d.m.th bazë tenderit të shpallur. Tenderin e ka fitu Karitasi dhe pagesat bëhen si kompanitë e pastrimit, që i bënë njëjtë.

**z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe pse jemi në gjysmën e

muajit të Ramazanit, është seanca e parë që po e mbajmë, prandaj të gjitha ata që e respektojnë Ramazanin dhe janë tu agjëru, ju dëshiroj agjërim të letë edhe kryerjen e kësaj pjese që na ka mbet. Do të bëjë përpjekje me ju përgjigj të gjitha pyetjeve që janë parashtru. Jakupi tha, dijet se kush vjen sekretar shkolle. E di që kanë me ardh profesionist, e bindu që emrat nuk i di se kush ka me ardh. Nënshkrimi e marrëveshjes, e ceku Nuredini për 12 fshatra. Unë konsideroj që ka pas shumë pyetje lidhur me ujin. Jam marr shumë me seriozitet të madh edhe unë, shume her i kame ndërpre takimet nga pakënaqësia të cilën nga moslëvizshmëria e punëve të cilat i kemi kerku. Megjithatë, në momentin kur e ki një CDI e cila është implementuese dhe obligative për çështjen e ujësjellësit dhe bazë ligjit, shumë herë, krejt atë pakënaqësi duhesh me e rikthy edhe me ristartu taman në fillim. Prej fillimit kemi bë të gjitha përpjekjet, çdo formë që punët të hecin e të përfundojnë sa më shpejtë. Jemi kanë n'gjendje si komune së bashku me ju me i kry të gjitha obligimet të cilat në rast që ju i keni thanë njëherë na e kemi përsërit nja 60-70 herë pa ndërpre. A kemi pru vendim, e kemi pagu borxhin e pesë fshatrave. Jemi kanë në gjendje krejt obligimet edhe si ekzekutiv edhe si kuvend, krejt me i kry ndaj CDI-së, në mënyrë që punët me shku me shpejt e me mirë. Megjithatë gjendja është kjo që është dhe në fund kemi propozu, që ka qenë edhe anglezi aty, kemi thanë, që komuna është ne gjendje së bashku me kuvendit me nda mjete që me i përfshi krejt fshatrat edhe këto që janë për rehabilitim edhe ato që nuk kanë rrjet të ujësjellësit, pavarësish vlerës se asaj kontrate sa do të jet, ju keni eksperta, bënë edhe ju, qitne, bani parallogarinë dhe paramasen dhe jemi në gjendje edhe këtë me bë, që njëherë e përgjithmonë me përmbyll kaptinën e ujit të pijes për qytetarët e Komunës së Vitisë. Është punu në atë drejtim me muaj, e kane sjellë një marrëveshje e cila është tri paleshe, që e keni pa shumë herë, e kanë përdor këtë nga sinqeriteti, jo si politikan tu varke prej meje së bashku me Ekremin ose Jakupin do të lidhsha me afat. Kanë mu kry qeto, po rrugë tjetër nuk kemi pas. Presion kemi bë të vazhdueshëm kështu qyshe po naj bëni edhe ju, se jam për mi qu këto procese përpara, sa do të lëvizmi ta shofim ditët ne vijim. Unë konsideroj që e kemi bë punën me të mirë të mundshme si ekzekutiv. Çështja e pronave të AKP-së në prona komunale, e dijë që unë si nënkryetarë i komunës jam tu u marr me disa të cilët janë në Komunën e Vitisë, është tu shku shumë rëndë ajo çështje, besoj që kemi me marr edhe e merr përligjjen, megjithatë vjen një qeveri e njef AKP-ne vjen një tjetër thotë do të ja marrim kompetencat krejt, këto po na pengojnë në shumë çështje, po megjithatë mund ta bisedojmë edhe me përafërt e me marr përgjigjen. Bekimi pyeti për marrëveshjen për stadium. E di që kemi pas me sjell po e kemi drejtorin të izoluar prej Covid 19, besoj që në seancën e radhës e sjellin. Pyetja që e parashtroj Bekimi, nuk është praktik që po e hasim për herë të parë. Unë kur e kam marr pozitën e nënkryetarit ne vitin 2014, u kanë njëfar gjipi, nuk kishe pas goma dhe i porosita, kur erdhe ai zotnia me tha, qekaq kushtojnë, mu dokën shumë edhe zuna kontratën sikur Bekimi që e paska zan me bandash edhe gomat ishin kanë 1 euro, i porosita me bandash. D.m.th kjo është si rutina, ndodh tash qysh tek po të tregoj që nuk është për herë të parë të jeni të bindur, merrne hulumtone. Taulanit pyeti për semaforët, a janë të vendosura ligjërisht. Unë konsideroj që po, e kemi planin e mobilitetit që e kemi votu, e ku në atë plan kanë punu ekspert të mundshëm që kane pas dhanë dy variante. Ku i pari ka qenë rrethrrutullimi të cilin komuna e kishte problematik për shkak se u deshke me bë shpronësimin e pronave, e cila kushtojmë dhe e dyta ka qenë një oazë që e quajnë këta, që ne kemi konsideru që semaforët janë me të mirë se qajo oaz na në aspektin profesional. Unë besoj që ata të cilët janë profesionist kane me u marr edhe me lartësinë edhe me vendosje, e besoj që janë vendos mirë. Në vitin 2019, komisioni për emërtimin e rrugëve dhe sesheve, besoj që ai komision është i formuar nga ana e kuvendit. Keni mujt me e funksionalizu edhe ti me e dhanë kontributin tanë, mos me i bë pyetje ekzekutives po me i bë kuvendit edhe vetvetes edhe me e aktualizu e me u marr me këtë çështje që e ka kompetencën e vet ai komision. Tregu i kafshëve. Ne ja kemi dhënë operatorit e se shpejti besoj që ka fillu edhe hudhja e rërës e se shpejti do të funksionalizohet. Sejda e parashtroj çështjen e shtyllave ndriçuese tek zebrat, që konsideroj është shume me vend, duhet me i shiku mundësitë buxhetore. Në Lubishtë, rruga "Avdullah Emini", e pa asfaltuar, ndriçim nuk e di sa s'kanë, është me rendësi qendrat me pas, fermerët me barna ka komuna që zgjedhin format të ndryshme

dikush jep far, dikush inkubator, nuk është e rregullume që vetëm far me dhanë, është forma dhe mënyra se cilën e zgjedh komuna. Banesat tek NLB-ja. Po të tregoj që është e planifikuar dhe do të rregullohet ajo që e parashtrove ti. Kanalizimi në Goshicë. Unë e di ato tri shpi e di edhe çështjen e konfliktit, po nuk po du me bë politik, po duhet me shiku me bë zgjidhje aty. Rruga Skifteraj-Goden. Unë besoj që e kanë obligim ata menaxherët e kontratës me dal me këqyrë deri sa e ka garancinë, e kur nuk e ka është çështje tjetër. Nuredin, është çështja e rehabilitimit të ujit ashtu qysh e kanë pas Letnica. Tash momentalisht është e përfshimë në kontratë vetëm shtimi i 20 litra për sekond, që nuk mjafton për dëshirën tane që e ki për Skifteraj.

**znj.Liridona Bislimi:** Nënkryetar, sinqerisht në përgjigjen që e dhanë me mirë ish dash me dal e me thanë nuk po di, nuk kame përgjigje ose nuk e di a je i njëjti ai që ma ke dhanë përgjigjen me herët, sepse nuk është hera e parë që unë dal e bëjë këtë pyetje. Unë kam qenë pjesë e KPF-së, kryesues dy herë të kam thanë aty çka ka ndodh me komisionin për emërtimin e rrugëve, je përgjigj këtë muaj do e thërrasim komisionin. Tash është shku njeri i ka mbledh nënshkrimet e banorëve, ka dal e ka thirr këshillin e fshatit, kryesinë e ka marr nënshkrimet ka shku në komunë ju ka thanë çka me bë me këtë se kemi probleme me emërtimin e rrugëve në komunë. Nuk e di kush i ka thanë shko tek Liridona. Unë po ju tregoj çka me ka than ai njeri mu edhe tash unë po bëjë pyetje: çka m bë, qysh e tek?, e del nënkryetari me thotë, Lirdonë, thirre komisionin. Qysh, a unë jam në pozitë apo ju jeni.

**z.Naim Pira, kryesues i kuvendit**: Neve na ka ardh propozimi për mu formu komisioni për emërtimin e rrugëve. Ne e kemi kry punën tonë, çka po pret tash prej kryesuesi, unë nuk jam anëtar i këtij komisioni.

**z.Ekerm Abazi:** Tek përgjigja për ujësjellës, besoj që edhe për këtë muaj afat kohor që e tha këshilltari i kryetarit për financa, këtë vetëm japonezët mujnë me e bë, po ndoshta kësaj here bëhem si japonët edhe na po në bazë të punëve që janë kry përpara për ujësjellës, besoj që kjo nuk ja vlenë fare me e thanë, po ishalla bëhet pas një viti jam i kënaqtë edhe pas një viti mu bë, mu fornizu këto 12 fshatra me ujë. Tek rruga, unë e thashë e kam thanë edhe me herët, që me zanë afatin kohor kur e ka obligim firma mu kujdes për atë rrugë që e ka shtru e po dyshoj që nëse shtyhet afati kohor që mundeni me bë edhe këtë mos me kry më pare të veta, se ai person që e ka kry atë punë është dashtë mu dënu e unë kam frikë që po kalon afati kohor njëvjeçar edhe ai nuk e mbikëqyr më fare e po dëmtohet buxheti i komunës. Për këtë e kam bë punë të madhe, ju kam thanë me herët që me qenë ju të gatshëm që në atë afatin kohor me zanë e mos me kalu, e nëse kalon afati dine që ju jeni tu ja vjedh paret e qytetarit të Komunës së Vitisë, me qellim 100% të caktuar. D.m.th tani që ati punëkryesit me ja ndihmu se ai gjithmonë ato punë që po i kryen, po i kryen shumë keq, po po i fiton tenderët përherë, edhe kësaj here ndoshta po ju lus që mos e bëni punën me shtru atë rrugë me pare, me buxhet të komunës, me u demtu qytetarët, e me u pas kanë në kushte normale u dashtë me e dënu edhe mbikëqyrësit që kanë qenë, edhe punëkryesin. Po nuk i keni dënu as ata që e ka marr tenderin, punëkryesin, as mbikëqyrsat, se me siguri po dyshoj që ju po bashkëpunoni me ata punëkryes që po i merr të gjitha tenderët. Ndoshta keni naj përqindje, fitim nga ata tendera që i merr ai person.

**z.Bekim Azizi:** Po ndërlidhem tek komisioni për emërtimin e rrugëve, pasi u përmend, komisionet që formohen nuk ka mundësi as unë me thirr, as ti Liridonë, sepse hala nuk është bë konstituimi i komisionit, mu zgjedh kryetari i komisionit, që me marr detyrat që me thirr komisionin. Unë mendoj që është e sekretarisë tuaj kryesues, me bë takimin e parë, edhe prej aty nëse ka kërkesa me fillu ato kërkesa me procedura të rregullta.

**z.Remzi Salihu:** Drejtoreshë, faleminderit për përgjigjen që ma jep, po unë nuk jam aspak i kënaqur me përgjigje. Thave se ato i mbikëqyrë Karitasi edhe e bënë pagesën Karitasi për ata punëtor të cilët janë me kontrata e pa kontrata ku ta di unë. Po unë tash shtroj pyetjen tjetër: si është e mundshme, që komuna të bëjë pagesën e 17 mije euro mujore dhe të mos dijë se për kë e bënë atë pagesë dhe kujt ja jep ato pare Karitasi? Kontratën nuk e di si është, po supozohet që ne atë pagesë ka njerëz që rrinë te shpija fare kot dhe paguhen, supozohet, sa është e vërtet nuk e di unë edhe njëherë po e përsëris, qëndroj pranë kërkesës që e kam bë në seancën e kalume dhe

nëse nuk marr përgjigje, çështjes do t'i shkoj tutje, pse e kam bë kërkesën në mënyrë të drejtpërdrejt këtu përmes kuvendit është, se kam kërkuar përmes zyrës disa herë dhe kam marr vazhdimisht përgjigje gjysmake apo qesharake. Prandaj, edhe këtë kërkesë e kam bë kështu në mënyrë publike, përmes kuvendit.

**z.Nuredin Luftiu:** Nënkryetar, lidhur me furnizimin e ujit e ceka, sepse unë dyshoj se banorët e fshatit Skifteraj pranojnë prapë të furnizohen me ujë të pusave afër "Moraves". Unë konsideroj që këto mjete të cilat shpenzohen në atë drejtim me mire kishte dashtë me u shpenzu mu shtu kapacitetet e ujësjellësit të Letnicës dhe pastaj me shku me ujësjellës si duhet njëherë e përgjithmonë me përfundu.

**z.Jakup Demiri:** Drejtor, tek puna e kontratës, mirë që të koka qashtu, po ne prej kontratave dhe tenderëve gogjo e dimë se si ka qenë situata. Unë e kam këtu nja të vitit 2019-2020 dhe shkruan 115 mijë euro e atë tjetrën nuk e kam pa, po prapë edhe nga kjo si që e shpjegove edhe ti, ndryshon çmimi me të madhe, ndërsa paramasa nuk kam pa që kanë ndryshu e me pas një qasje unë edhe me kuptu, për shkak tek puna e çmimit, tek puna e sekretarëve. Nënkryetar, të premtoj që është shume e saktë, e për drejtoreshën e shëndetësisë, edhe unë jam pjesë e atyre që e kërkoj atë listë, se zot shpije jemi ne e jo Karitasi. Je drejtoreshë e shëndetësisë e nuk paske të drejtë ose na nuk pasmi të drejtë me pa qat listë, kjo është absurde. Për seancën tjetër edhe unë e du qat listë.

**z.Taulan Haxhiu:** Nënkryetar, ti ma jap përgjigjen, po e dinë saktë që keni pas edhe vërejtje prej inspektorave të ministrisë, se ata samafora janë të vendosur jashtë ligjshëm aty në atë vend. Nënkryetar, jeni dal në televizione publike dhe jeni kanë hit i Prillit me këta samaforë, edhe nuk po e di a janë ligjërisht aty a po jo, po le ta dinë qytetarët se ata janë jashtëligjshëm të vendosur aty.

**z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës:** Taulant, me sinqeritet po të thamë, nëse jemi shpall hit i Prillit, po me vjen mirë shumë, jam i sinqertë edhe në televizion kur te jam me e thanë të vërteten, asnjë jashtë të vërtetës. Kurrë në paraqitjet e mia publike nuk iki aspektit a janë ligjore apo jo. Duhet me kontrollu ekspertet, janë inspektorët e komunikacionit të cilët e dinë edhe lartësinë e tyre, etj. Politika e ka për qellim me ju dal kërkesave të qytetarëve, është kërkesë e qytetarëve me ju bë zgjidhje në udhëkryq. Kjo është një nder format më të mira të mundeshe për momentin dhe e kemi bë dhe një çështje tjetër, mbaje mend, nuk janë krejt qytetaret e Vitisë si ti ka nxënës të cilët e kryen edhe shkollën e mesme edhe nuk ballafaqohen me samaforë kurr. Unë e mbroj këtë, se unë e kam pa semaforin për herë të parë kur jam shku në Prishtinë si gjeneratë edhe plotë janë si unë, vetëm që duhet me qenë të sinqertë me e thanë këtë. Janë dy përfitime, përveç zgjidhjes se problemeve dhe që mundet me pas edhe pshtim të jetëve të njerëzve. Edhe nxënësit mujn me pa edhe praktikisht komunën e vet që jetojnë se si funksionon.

**Kryesuesi z. Naim Pira:** Për seancën e katërt të rregullt të Kuvendi Komunal të Vitisë, kemi para këtë:

## Rend dite

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e KK-së.**
2. **Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2021.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2020 ne vitin 2021.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të integritetit për komunën e Vitisë 2021-2023.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin komisioni për procedurat e mëtutjeshme të dhënies me qira të vendgjuetisë ne territorin e Komunës së Vitisë.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik (Parkingjet publike).**
7. **Informatë për Manifestimin e Tradicional Kulturor-Sportiv Flakdani i Karadakut-2021.**
8. **Informate mbi përgatitjen e të mbjellave pranverore.**

A ka dikush rreth rendit të ditës? Nga të gjithë u miratu rendit i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e KK-së**

**Kryesuesi z.Naim Pira**: Hapi debat rreth procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

**z.Remzi Salihu:** Tek faqja nr. 2, tek diskutimi im, aty është një gabim: ku ka mrri shifra. Duhet me qenë: ku ma mrri çështja.

**Kryesuesi z.Naim Pira** E hedh në votim procesverbalin me këtë vërejtjen e Remziut. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

Pika e dytë e rendit të ditës:

**2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2021**

**z.Ibrahim Rama, drejtor i financave:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Si zakonisht ekzekutivi, Drejtoria për Financa, çdo tre muaj është e detyruar të paraqes raport financiar para kuvendit komunal për ekzekutimin e buxhetit, që ka të bëjë me buxhetin e vitit 2021. Kësaj radhe është fjala për pasqyrat financiare, gjegjësisht realizimin e buxhetit për periudhën janar - mars të vitit 2021. Po mundohem në pika të shkurta ta prezantoj këtë pikë. Pasqyrat kanë kaluar edhe në Bordin e Drejtorëve dhe në KPF-në, e ka marr leje për mu adresu në kuvend. Gjatë kësaj periudhe janë aloku në buxhetin e Komunës së Vitisë, 3 milion e 286 mijë euro. Nga kjo shumë, qeveria komunale ka shpeznu këtë buxhet në total në shumën prej 2 milion 567 mije euro, apo shprehur në përqindje 78.14%. Ky shpenzim i shpërndarë nëpër kategori ekonomike, duket si në vijim: Në kategorinë për paga dhe shtesa, buxheti është shpenzu 99.91%; në kategorinë për mallra dhe shërbime, 45.44%; shpenzimet komunale, 39.77%; subvencionet, 9.77;% dhe kategoria ekonomike për investime kapitale, 44.24%. Pra, në total buxheti është shpenzu 78.14%. Materialin e keni marr me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**z.Naim Pira, kryesues i kuvendit**: Hapi debat për këtë pikë.

**z.Ali Bajrami:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! E falënderojmë drejtorin për këto pasqyra edhe për këtë obligim ligjor që është duke e përmbushur. Me Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Financat Lokale dhe Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike, i kemi pasqyrat për periudhën kohore janar-mars 2021. Mos me hi me i përsërit ato që i tha drejtori, isha ndal te disa kaptina. Ajo që vlen të përshëndes dhe që është bë një punë e mirë, është tek të hyrat ku kemi një rritje për këtë periudhë kohore prej 64 mijë e 929 euro. Të hyrat në përqindje që janë inkasu për këtë tre mujor janë 27.49%; shpenzimi i buxhetit është një shpenzim solid prej 78,14%; drejtori e elaboroj, pse kjo përqindje nuk është më e lartë, po kur t'i marrmi krejt rrethanat në të cilat është punu e është vepru, nuk është që nuk është shpenzu pak. Nëse hymë tek zyrat, prej Zyrës së Kryetarit, e drejtorëve, ku më pak e ku më shumë kemi shpenzimin e buxhetit prej 78,14%. Ajo çka me ra në sy tek arsimi, pagesa e vendimeve gjyqësore, një e drejtë që ju ka taku punëtorëve, që është në vlerë prej 56 mijë e 945 euro, do të ndikoj në buxhet, po megjithatë duhet të kryhet ky obligim ligjor, se është e ligjshme. Tek investimet kapitale, kemi vlerën 337 mije e 183 euro e 86 cent, shpenzimi për këtë tremujor është 44,24%. Ajo çka është për tu përgëzuar, se drejtori naj ka sjell edhe përshkrimin e kodeve të caktuara, që janë shpenzime që shtrohet gjithherë pyetje. Unë në kudër të kësaj kam edhe një pyetje, se përshkrimi i kodeve, numri rendor 26, kodi 14410, se kemi edhe tek arsimi, pagesa e vendimeve gjyqësore, kemi edhe në këtë kod 14410, shpenzime, vendime të gjykatave 4362 euro. A janë të përfshimë në këtë shumën e përgjithshme apo janë të veçantë ky kod edhe kodi i arsimit. E ceku drejtori, rritja e të hyrave vetanake 118.% Është një falënderim edhe për qytetarët që ju kanë përgjigj këtij obligimi, sepse është një e mirë që këto mjete në mënyrë direkte ju kthehen në shfrytëzim qytetarëve.

**z.Jakup Demiri:** Drejtor, po filloj nga pagesat për vendimet gjyqësore. A muj me ditë cilat janë vendimet gjyqësore. Tek shërbimet për të gjitha njësitë buxhetore, i kemi 56 mije e 945 euro. Këtu e kemi edhe një shumë, mirëmbajtja e rrugëve lokale 42239 euro. Si shumë po me doket e madhe. Një sqarim për këtë. Shpenzimet e Zyrës se Kryetarit, shpenzimet kontraktuese tjera. Drejtor, e morra listën, ka me këqyrë, janë 5455 euro shpenzime të vendimeve të gjykatave. Tek administrata dhe personeli, një përgjigje. Shpenzimet e telefonisë mobile, për tre muaj keni paguar 3787 euro telefon mobil. A është shumë e madhe kjo për këtë periudhë. Kodi 13430, shërbime në zyrën e shëndetësore 35795 euro. A është kjo me Karitasin apo ndonjë tjetër. Totali i subvencioneve, investime kapitale 6943 euro. Çfarë investime janë bë nga ky kod, nuk po e kuptoj këtë. Kodi 13460, shërbime kontraktuese tjera. Çfarë shërbime janë kontraktu nga ky kod buxhetor tek Drejtoria e Arsimit. Drejtor, e përmende edhe të hyrat tek tatimi, që janë të rritura dikun me 118 % Ju uroj për këtë. Po të hyrat nga donacionet për periudhën janar- mars 2021, nuk ka pas. Edhe këtu është një dështim, sepse vitin e kaluar kemi pas, tek subvencionet është 9.77% Pse kjo përqindje e ulët, kur e dimë që është koha e të mbjellave të kulturave bujqësore. Shpenzimet për subvencione në transfere të vitit 2021, janë kategorizu 5490 euro në krahasim me vitin e kaluar 5500 euro.

**z.Taulant Haxhiu:** Investime për periudhën janar-mars 2021. Unë i kam tri me të rëndësishme: asfaltimi rrugëve rurale, 78 mijë e 850 euro. Është jashtëzakonisht një shumë e madhe. Rregullimi i rrugëve me zhavar 200 e 1000 e 390 euro, po kjo për Prishtinën është shumë e le ma për Viti. Asfaltimi i rrugës me zhavar, Kabash, Goshicë, Verban, Beguncë. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik, 50 mijë euro. E kryetar, gjithmonë kur po i ndreqni 20-30 centimetra po i leni pa u ndreq, çdo kund. Nuk e di për çka, ndoshta e keni atë me i hëngër uki, apo pse po i leni ashtu çdo kund ku keni rregullim të treturave 20-30 centimetra e leni pa ndreq? Unë, këto shifra janë enorme, asfaltimi i rrugëve rurale 78 mijë është jashtëzakonisht shumë. Renovimi i ambulantes, 6940 euro. Kjo është një shumë solide, ndërsa për ato trija që i ceka, është mirë me ma dhanë një sqarim.

**z.Samet Idrizi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pasqyrat financiare me shfaqjen e Covid 19 është bë problem me bë krahasim të mirëfilltë, po megjithatë mu shka më ra në sy këtu, inkasimi prej 46 mijë euro me shumë që po me duket për mu ka ndodhe spontanisht. Si do që të jetë, mirë është që ka ndodh ajo çka po du me ja bë një pyetje drejtorit, e besoj që me jep sqarim. Shpenzimet këtë vit për tremujorësh, krahasuar me 2020, e kemi 448263 euro me shumë. Pse ka ndodhë? Sidomos shpenzimet për paga dhe mëditje për vitin 2021 janë më të larta për 162 mije euro. Nëse ka mundësi: pse, qysh kanë ardh këto? Po ashtu shpenzimet për shërbime dhe mallra, tu e ditë që jemi tu punu komplet kompanitë publike po edhe private me kapacitet përgjysmuar, pse ka ndodhë kjo rritje bash në këtë kohë.

**z.Ibrahim Rama, drejtor i financave:** Faleminderit kryesues! Do të mundohem aq të ju përgjigjem pyetjeve të parashtruara. Po filloj nga pyetjet e Sametit, krahasimi i buxheteve. Unë kam thanë përherë, asnjëherë ekzekutimi i buxhetit çoftë se ka ndonjë shkaqe objektive për mungesë ndonjë stafi të bllokimit të llogaris së komunës apo tjera, që mundet me pas arsyetim për me pas ndryshime ne ekzekutimin e TM1, krahasuar me TM1 të vitit paraprak. Zakonisht me buxhetet janë të planifikuara, ndryshe secili buxhet prej një viti në vitin tjetër edhe ekzekutimi i buxhetit bëhet ndryshe në bazë të atyre dinamikave që i kane planifiku cilat drejtori për secilën buxhet të vetin veç e veç. Kështu që, unë për herë kam thanë krahasime e pasqyrave financiare, gjegjësisht e pozicioneve të buxhetit brenda për brenda strukturës së tij krahasuar me një vit përpara, asnjëherë nuk përputhet dhe asnjëherë nuk mund të jete objekt vlerësimi për me qenë një raport financiar i drejt apo jo i drejt. Këto shënime që sot janë para juve, pasqyrojnë buxhetin e vitit 2021. Krahasimet janë vetëm udhërrëfyes për me pa veten a keni planifiku drejt apo nuk kemi planifiku drejt, përndryshe për gjykim profesional krahasimet nuk janë të nevojshme. Në pasqyrat financiare paraqitet saktë ajo që është shfrytëzu deri me 31.03.2021. Kemi pas këtë drejtim. TM1 e parë, pra është fjala në mënyrë profesionale në ngecje në shuma në vlerën nomilane të buxhetit për hirë që punëtori na ka mungu një kohë, punëtori i zotimeve të mjeteve në Drejtorinë e Financave. Unë besoj

që në këtë aspekt nuk kemi me pas më probleme, po problemi kryesor i shumave kur bënë krahasim apo kërkon vlera pse është me e madhe tek telefonia mobile apo tek shpenzimet e informimit publik. Të gjitha këto që kanë ndodh janë në kuadër të buxhetit të planifikuar shume ose pak nuk ka sanksione, secili drejtor në secilën drejtori duhet me shpenzu buxhetin aq sa është i planifikuar dhe i miratuar nga ju këshilltar. Sa i përket investimeve kapitale, pagesave prej 337,000. Sipas Taulantit i doket shumë ose arsyeshmëria është e pa mjaftuar. Raporti financiar paraqet shumën e faturave edhe tek rrugët rurale edhe tek asfaltimet e rrugëve me zhavar. D.m.th këto pagesa. Na e dimë që në tremujorin e parë nuk janë punu, nuk janë kry këto punë në vitin 2021. Pasqyrat financiare e njofin momentin e realizimit te shpenzimit të buxhetit, periudhën se ne cilën datë shpenzohet buxheti në qat periudhe duhet mu paraqit para juve si raport financiar këto shpenzime që janë bë edhe tek asfaltimi i rrugëve rurale edhe tek rrugët me zhavar, edhe tek ndërtimi i trotuareve, janë punë që janë kry në vitin 2020 dhe faturat janë paraqit edhe para juve në raportin financiar në fund të vitit. D.m.th faturat që nuk kanë arrit mu pagu ne vitin 2020 e janë në raportin financiar të fundvitit të kaluar dhe që i kemi lajmëruar në Ministrin e Financave, janë pagu në periudhën janar-mars të këtij viti. Në këtë drejtim jemi në rregull edhe me pagesat e faturave, se 200 mijë euro rrugë me zhavar në janar-mars nuk ka shancë mu kry, po as 70 mijë euro asfaltim jo. Kështu që, janë obligime të vitit 2020. Ka shumë pyetje. Jakupi bëni pyetje në disa parametra të kodeve të pasqyrave financiare, një prej tyre p.sh.: kodi 13460, shërbimet kontraktuese. Unë ja kam sjell raportin. Pyetja tjetër ishte subvencionet e realizuara 9.97% Nuk kemi pas mundësi, Drejtoria e Bujqësisë e ka planin për subvencione për vitin 2021. Bile me miratimin e juaj të nderuar këshilltar komunal, fondi për subvencione është më i madh për 60 mijë, më doket më shumë se vitin e kaluar. Kështu që ai fond prej 160 mijë euro duhet të shpenzohet këtë vit. Këta nuk kanë parapa, sigurish që është edhe tremujori i parë e nuk mundet me pas subvencione së paku me sa e njof unë këtë lëmi, tani në fund të muajit mars, kane fillu disa aktivitete. Kështu që pagesat e këtyre subvencioneve dalin në tremujorin e dytë. Kemi bë përpjekje, bile që dy vite i kemi rrit subvencionet në bujqësi, besoj që nuk kemi me pas problem me i shpërnda këto subvencione. Për të gjitha që doni me pas informacione me të gjera, muj mbledhjen e radhës me ju sjellë.

**z.Samet Idrizi:** Drejtori nuk më dha përgjigjeje për 162 mije euro për paga dhe mëditje me shume që janë pagu. Më bëni shume përshtypje drejtori kur tha, këto pasqyrat financiare në tremujor, nuk krahasohen nëse e qelni pasqyrat vetëm faqen e dyte, e shini vetë. Ky fillon me krahasim, nuk mundesh me i ik krahasimit.

**z.Taulant Haxhiu:** Drejtor, nëse mundesh me mi dhanë qeto faturat, sidomos tek kjo asfaltimi i rrugëve rurale. Masi te koka edhe punëkryesi. Kjo kompania e famshme ProCo Grup edhe Eskavatori me mi dhanë faturat për me i pa, edhe subvencione. A e dinë pse nuk i ki dhanë në tremujorin e parë, se tash jemi afër zgjedhjeve dhe jeni tu e ruajt për zgjedhje.

**z.Jakup Demiri:** Drejtor, për disa pyetje nuk morra përgjigje. Nja tek puna e pagesave të vendimeve gjyqësore. Ti e dinë çka ki pagu. Tek kodi 300, janë investime kapitale 6943 euro, çka është pagu me këto, ndërsa tek shpenzimet e rrymës, pavarësisht planifikimit, nëse pernime edhe e keni planifiku afër 4000 mijë euro për tre muaj me i hargju, është gogjo shqetësuese në këtë kohë me hargju kaq shumë në telefon, gogjo shumë.

**z.Nexhmedin Jakupi:** Jakupi i bëni dy pyetje që muj unë me ju përgjigj rreth telefonisë mobile. Po na e kemi një kontratë për telefonat mobil dhe kemi shpenzime mujore dikun 1000 euro, mirëpo për këto dy muaj është 3787 euro që janë bë pagesat. Sigurish është e muajit 12 të vitit të kaluar. Dhe pyetja tjetër, tek kodi 14032 mirëmbajtja e autorrugëve lokale me këtë kod paguhen dy projekte të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, projekti mirëmbajtja e rrugëve lokale gjate verës dhe domërit dhe mirëmbajtja e hapësirave publike me qet kod paguhen, se i kam të dhënat e sakta, se gjatë këtij viti kemi bë shpenzime për mirëmbajtje dimërore të rrugëve dikun 22 mije euro dhe dikun shtator-tetor prej kur e kemi lidh kontratën për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve i kemi shpenzu dikun 50 mije euro prej shtatorit e knej për këtë tre mujor me qet kod janë pagu dy projekte 24 mije euro: janë mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe dikun 17 mije e 791 euro dikune pastrimi i hapësirave publike.

**z.Naim Pira, kryesues i kuvendit:** Faleminderit për këto sqarime!

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

**3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2020 ne vitin 2021**

**z.Ibrahim Rama drejtor i financave:** Çdo vit fiskal kur përfundon me 31.12 është e pamundur që buxheti të shpenzohet 100%, për shkak të të hyrave që mblidhen në muajin e fundit, zakonisht afati i fundit për realizim të pagesës është 24 dhjetor. Në vitin e klum na kanë mbet pa u shfrytëzu mjetet e grumbulluara edhe nga niveli qendror edhe nga të hyrat vetanake. Shuma prej 189 mijë e 721 euro. Këto mjete duhet me vendim të kuvendit komunal të barten në vitin 2021 në të gjitha ato pozicione që kanë qenë të planifikuara me buxhet. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**z.Naim Pira, kryesues:** Hapi debat për këtë pikë.

**z.Ali Bajrami:** E përshëndesim kryetarin që na u bashkëngjit në punën e kuvendit. Këtë propozim që e kemi para vete, është mirë ta mbështesim, është praktik e viteve të mëparshme, kemi mjetet nga të hyrat vetanake dhe nga viti paraprak fiskal që nuk janë shpenzu. Ne si grup parlamentar i LDK-së e mbështesim këtë propozim vendim.

**z.Naim Pira kryesues i kuvendit:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt kemi:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të integritetit për komunën e Vitisë 2021-2023**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Të nderuar këshilltar, i nderuar kryetar i komunës! Ju e keni materialin para vete, në KPF janë dhënë disa vërejtje, po aty vendosëm që mos mi ndryshu për shkak se materiali është shumë voluminoz, e prandaj janë disa gabime teknike. Po këto do të korrigjohen, po nëse keni ndonjë vërejtje ju, do t'i inkorporojmë. Plani i integritetit punohet për herë të dytë në qeverisjen komunale dhe është një prej kritereve të performancës. Materialin e keni para vete, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë kemi:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin komisioni për procedurat e mëtutjeshme të dhënies me qira të vendgjuetisë ne territorin e Komunës së Vitisë**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Është propozim nga Zyra e Kryetarit për formimin e komisionit që përbehet nga ekzekutivi dhe legjislativi, për me i udhëheq procedurat e mëtutjeshme, për dhënien me qira. Prandaj i keni dy emra aty që janë dal nga ekzekutivi. Tani duhet dy grupet parlamentare me e propozu nga një anëtar dhe një nga shoqëria civile.

**z.Ali Bajrami**: Ne e propozojmë, Basri Sylejmanin

**z. Jakup Demiri:** Ne e propozojmë, Remzi Salihu

**z.Naim Pira, kryesuesi:** Tani e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe ky propozim vendim.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik (Parkingjet publike)**

**znj.Majlinda Ostrogllava, drejtoresh e kadastrit:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ne kemi ardh me propozim për parkingjet publike. Këtë propozim e kemi pas edhe në seancat e mëhershme, po për shkak që nuk e kemi pas listën, e kemi pas problem me kalu. Tani jemi në rregull, materialin e keni marr me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicioni e juaj.

**z.Naim Pira, kryesues i kuvendit:** Hapi debat për këtë pike të rendit të ditës.

**z.Jakup Demiri:** A ka të drejtë kjo të jepet për një vit e jo për tre vite, sepse po me doket shume tri vite. Deshta me e përshëndet edhe kryetarin i cili pasi të kryhet pjesa e rëndësishme vjen. Këtë e ka praktik, e kryetar po i ik debateve që i ki obligim.

**z.Taulan Haxhiu:** Është mirë me ardh kryetar ti, sepse kur të jesh ti këtu debati është më e nxehtë dhe opozita ka çka të thotë. Për propozimin e parkingjeve publike, na e dimë që parkingjet kanë qenë edhe tek sheshi, e ku tash sheshi është ndryshu, nuk është si me herët hapësira. Tash shfrytëzohet vetëm prej pasqyrës e deri këtu tek banka ekonomike, e tash parkingjet janë zanë me shesh, e ku t'i parkojmë kerret. A keni mëndu edhe naj alternativ tjetër, që atë parking ta kompensojmë me naj anë tjetër të parkingjeve.

**z.Sejdi Emini:** Kur jemi tek dhënia e shfrytëzimit të pronës publike për parkingje, duhet me mëndu mirë që është vit pandemik. U tha që marrin 12-13 persona aty pagë, mirëpo i kemi 60 mijë qytetar që ndoshta duhet me mëndu edhe për këta, e që në këtë kohë pandemie u kanë mirë me e lan në shfrytëzim të qytetarëve, sepse dijet që viti është i vështir. Gjendja ekonomike e këtyre është e vështirë, ndoshta është mirë me mëndu që deri sa jemi në pandemi me lan në shfrytëzim të qytetarëve qyshe është tani. Pasi jemi tek kjo pika, kisha kërku që pjesën aty përball komunës se vjetër, janë dikun 10 parkingje, atë pjesë me ja leju taksistëve, të cilët me të vërtet po përballen për çdo ditë me sfida të bukës së gojës. Personalisht më kanë kërku mu këtë, është vend adekuat për ata, ndoshta është mirë që me marr një vendim, që qat pjesë, është edhe hije për ta, është mirë që atë pjesë me ja leju taksistëve të cilët gjenden këtu në shesh. Është kërkesë, që besoj është e arsyeshme, e duhet të kalojë. Unë jam edhe për këtë kërkesë.

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket çështjes së parkingjeve, me të drejtë e shtroj Taulanti alternativën. Duhet me pas, sepse Vitia ka nevojë, prandaj nevoja për parkingje edhe e madhe. E kemi projektu, projektin ideor kemi me bë detal dhe natyrisht do pas shtëpisë së kulturës, prej fillimit të shtëpisë se kulturës, deri te pasqyra, që me bë një rendë për parkingje. Natyrisht atë rrugë me bë 7 metra, e kemi parapa këtë, me grandin e perfomances do ta realizojmë këtë bashkërisht e me këtë realizohet një pjesë e planit të mobilitetit. Duhet me i shiku edhe propozimet tjera që janë, besoj që kemi me qenë në bashkëpunim e me fillu këtë vit. Sa i përket ardhjes time këtu në kuvend, kam ardh dhe ka me ardh, nuk i iku debateve, po me rëndësi ne po e furnizojmë kuvendit me pika të rendit të ditës.

**z.Taulant Haxhiu:** Tek taksistët, kolegu Sejd shumë mirë e tha, taksistët nuk po kanë vend të caktuar e ku taksistët në të gjitha vendet e botes vendosen në shesh, ku ka frekuentim të njerëzve. Na duhet me bë diçka për taksistët, me i pas disa parkingje të rezervuar për taksistë.

**z.Sokol Haliti:** Unë sa e di, përkohësisht janë bë parkingjet e taksisteve. Drejtori i inspeksionit qenka këtu, e din më mirë.

**z.Naim Pira, kryesues i kuvendit**: Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Konstatoj që u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtat kemi:
7. **Informatë për Manifestimin e Tradicional Kulturor-Sportiv Flakdani i Karadakut-2021.**

**z. Ismet Sejdiu, zyrtar nga drejtoria e kulturës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pasi që drejtorin e kemi në vetëizolim, pasi që prindët i ka me Covid 19, me ka autorizuar mu që ta bëjë prezantimin e kësaj pike të rendit të ditës. Vitin e kaluar, edhe pse i kemi bë të gjitha përgatitjet e kësaj ngjarje kaq madhështore dhe prestigjioze, e cila zhvillohet në komunën tonë, për shkak të pandemisë i kemi pezullu të gjitha aktivitetet e manifestimit, kurse këtë vit po ashtu kemi fillu sipas rekomandimeve nga IKPSH-ja dhe në kontakt me drejtoreshën Vjollca Kadolli kemi fillu organizimin e këtij manifestimi. Manifestim në kuadër të cilit zhvillohen aktivitete të shumta kulturore dhe sportive, fillimisht kemi fillu me hapjen e manifestimit, ceremoninë e dhezjës së flakadakut në mënyrë solemne, ku kanë marr pjesë musafir të shumtë e në veçanti ata nga Lugina e Preshevës, duket fillu çoftë nga institucionet, organizatat e dala nga lufta e UÇK-së dhe e UÇMB-së si dhe organizatat tjera qeveritare dhe jo qeveritare, e ku në këtë manifestim ishte prezent edhe kryetari i Komunës së Preshevës, i cili e nderoj këtë manifestim. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**z.Naim Pira kryesues i kuvendit**: Hapi debat për këtë pike të rendit të ditës.

**z.Sejdi Emini:** Faleminderit për informatën. U tha që kanë ardh artista e shkrimtar nga të gjitha anët, d.m.th trevat shqiptare, mirëpo unë kam qenë në orën letrare atë ditë e ata shkrimtar i kemi shashtrisë, i kemi mërdhi, temperatura u kanë në minis, që njëri nder ata që jam detyru me dal jashtë jam kanë edhe unë. Kisha kërku që herave tjera me pas kujdes, se gjithë këto shpenzime që janë bë e që po arsyetohet që janë bë, u dashtë edhe dy tri nxemje, një temperaturë plus së paku me kriju aty, nuk ka pas kushte aty, besoj që pajton edhe ti me këtë.

**z.Taulant Haxhiu**: I nderuari Sejdiu, Flakadni i Karadakut që pesë gjashte vite është ka e humb çdo ditë e me shumë kuptimin e vet. Flakadanët e tjerë, manifestimet e tjera kur ka qenë më herët, ka pas me shumë shyret kjo punë, ka pas më shume njerëz, ka qenë një nder manifestimet me të mira në regjion. Flakadani i Karadakut -Njazi Azemi, e meriton të ketë një trajtim pak me të mirë me këtë manifestim, i cili ka fillu me 1000 vet, ka ra në 200 vet, e deri në 50 veta. Atë ditë, ditën e fundit kur jam kanë unë prezent, ishin kanë 42 veta. Nejse, është vit pandemiK, po edhe viti 2019-2018 çdo vit është ka i bien interesimi këtij manifestimi me të madhe kulturo - artistic Flakadani i Karadakut, sidomos me qeverisjen e Sokol Halitit, ajo vetëm është ka ju bien interesimi i qytetarëve.

**z.Hasan Aliu**: Taulant, në mesin e këshillit organizativ për atë dola e nuk dola me të repliku si nënkryetar po si anëtar I këshillit organizativ që 8 vite pa ndërpre jam në këshillin organizativ, Flakadani i Karadakut dhe po ta them, jo nuk jam mbrojtës i kërkujt, jam mbrojtës vetëm i vetvetes. Gjitha mekanizmat të cilët operojnë në Komunën e Vitisë, që morrin pjesë në këshill organizativ, tu fillu prej kryetarit të familjeve të dëshmorëve, kryetarit të veteranëve të luftës, në aspekt të organizimit të manifestimit të flakadakut dhe manifestimeve të tjera, kësaj qeveri komunale ja kanë dhënë notën dhjetë, dhe për rregull dhe rend nuk mund me krahasu asnjë pushtet, nuk e kam thanë unë kurrë nuk do ta kisha than, se do te vinë gjenerata tjera që do të avancojnë edhe më shumë, por duhet ta themi të vërtetën. Dy vitet e fundit, viti i kaluar që nuk u organizu hiq dhe kjo tani, të gjitha ata që kanë qenë e kanë pa organizmin e mirë. E marr si shqetësim atë mungesën e nxemjes, sepse është çështje teknike kjo, a sa i përket organizimit, mos të hime, sepse është fenomenal. Nuk ka këshill organizativ që është themelu e që nuk ka pjesëtar të subjekteve politike që nuk marrin pjesë. Tash kush ka kontribu, sa ka kontribu, është çështje e tyre.

**z.Naim Pira, kryesues i kuvendit**: Unë po e falënderoj për sjelljen e kësaj informate.

**Si pikë të tetë kemi:**
**8. Informate mbi përgatitjen e të mbjellave pranverore**

**znj.Arlinda Sahiti, drejtoreshë e bujqësisë:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural edhe kësaj here e kemi përgatit informatën mbi të mbjellat pranverore. Komuna e

Vitisë është një nder komunat më sipërfaqe të mëdha të të mbjellave me kultura të ndryshme bujqësore. Matrialin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi z.Naim Pira**: Hapi debat për këtë pike të rendit të ditës.

**z.Taulant Haxhiu:** E nderume drejtoreshë, unë ta kam thanë edhe në seancën e kalume një pyetje, po nuk me ki kthy përgjigjen. Pres tani me ma kthy përgjigjen. Rendimeti i planifikuar për hektar jogje 8500 kilogram, nuk po e kuptoj çka është kjo, edhe rendimenti i planifikuar për hektar tërthor 700 kilogram. Nëse mundesh më ma sqaru jogjen edhe tërthilin. Ju lutem e du përgjigjen prej drejtoreshës Arlinda Sahiti, jo prej kryetarit të komunës.

**znj.Arlinda Sahiti, drejtorshe:** Jogja është ushqim për kafshë, edhe terthili, edhe ky është gjithashtu ushqim për kafshë.

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Drejtoresha a paraqiti informatën para juve. Vitia, një pjese të madhe të planifikimeve vjeshtore dhe pranverore e realizon gjithmonë. Ne ju rrimë gati si komunë ,që t'i mbulojmë kërkesat. P.sh.: tani ju kemi ndihmu me makina mjelëse, ju kemi ndihmu me sera e subvencione të tjera.

**Kryesuesi z.Naim Pira**: Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë seancë.

Mbledhja përfundoj me punë në ora 12:20 min.

**Procesmbajtësi:**
**Fatlum Demiri**

____________

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**
**Naim Pira**

____________

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
10-06-2021
02-035/02-425

Republika e Kosovës

Komuna e Vitisë

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës ( Gazeta zyrtare nr 28/2008), dhe nenit 50 shkronja I) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.2011 , Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë :

# PROPOZIM VENDIM
## PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE ( KAB ) TË KOMUNËS SË VITISË 2022-2024

**Neni 1**

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal që të aprovoj Vendimin „ KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE ( KAB ) E KOMUNËS SË VITISË 2022-2024 "

Duke u bazuar në QARKOREN Buxhetore 2022/01 të datës 14.05.2021 me nr 06/400 nga Ministria e Financavee Punës dhe Treansfereve ku paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2022-2024.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është „KORNIZA AFATMESME BUXHETORE ( KAB ) E KOMUNËS SË VITISË 2022-2024 " e hartuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim .

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

PROPOZUES : KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosova

# KORNIZA AFATMESME BUXHETORE (KAB) E KOMUNËS SË VITISË 2022-2024

**Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim**

2021

# Përmbajtja

I. Hyrje

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale
3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2022-2024
3.3 Politikat e reja
3.4 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2022-2024

IV. Korniza e Shpenzimeve

# I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, është një dokument i cili përgatitet nga zyrtarët e administratës komunale dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2022/01 të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve .

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2022-2024 (KAB 2022-2024) paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2022. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë të bazuar për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë

Kornizës Afatmesme Buxhetore do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2022-2024. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtëme:



## II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

Komuna e Vitisë shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës, rajoni i Anamoravës përafërsisht 40 km në jug të Prishtinës. Kufizohet me 5 komuna tjera ( Gjilanin, Ferizajin, Kaçanikun dhe dy komuna të reja si Kllokotin e Parteshin dhe në jug me IRJM-në. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Lumi Morava e Binçës kalon përmes luginës qëndrore të Komunës ku krijon kushte më të favorshme për aktivitete bujqësore . Komuna e Vitisë ka gjithsej 39 fshatra. Sipas rezultateve preliminare të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Vitisë ka 46.987 banorë ( regjistrimi i vitit 2011) 2.64 % e popullsisë në total, madhësia gjeografike 270, popullsia pakicë në komunë 258, ( Qarkorja Buxhetore 2022-2024/01 faqe 12) të organizuar në 11,235 ekonomi familjare.

Komuna e Vitisë shtrihet në pjesën qendrore të fushëgropës së Moravës së Epërme përmes saj kalon lumi Morava e Binçës. Është e vendosur në një rrafshirë shumë pjellore, e përshtatshme për kultivimin e të gjitha bimëve bujqësore. Pas okupimit të trevave shqiptare (Kosovës) nga pushtuesit Osman, treva e Vitisë ishte pjesë e Nahisë së Moravës.

Gjatë Luftës së Parë Ballkanike (1912), sikur pjesët tjera të Kosovës, edhe Vitia me rrethinë okupohet nga Serbia, ndërsa gjatë Luftës së Parë Botërore okupohet nga Bullgaria, mandej në mes dy luftrave botrore ishte nën okupimin e Jugosllavisë (1918-1941). Gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte pjesë e zonës okupuese Bullgare , ndërsa në vjeshtë 1944 ripushtohet nga Jugosllavia komuniste. Vitia në vitin 1912 ishte shpallur komunë, ndërsa gjatë Mbretërisë Jugosllave ishte pjesë përbërse e Banonisë së Vardarit me qendër në Shkup. Në pikpamje administrative Vitia ishte komunë në vete si pjesë e Qarkut të Gjilanit. Në vitin 1952 nga qarku i Gjilanit formohen tri rrethe: Gjilani, Vitia, Dardana. Ndërsa në vitin 1959, kur transformohen rrethet, Vitia shëndërrohet Komunë në vete.

Vitia ka një sipërfaqe relativisht të rrafshet, një tokë mjaftë pjellore, sipërfaqe të konsiderueshme pyjore ( si pjesa e Karadakut të Shkupit, me majën e Kopilaçës me një lartësi praj 1490 m , male këto që formojnë edhe kufirin natyror mes Kosovës dhe Maqedonisë), por edhe rrjedha të mjaftueshme të lumenjve ( Morava e Binçës, Letnica etj.) Gjithashtu Vitia ka sasi të jo metaleve. Kjo komunë, me një sipërfaqe prej rreth 300 km², shtrihet në juglindje të Republikës së Kosovës. Nga magjistralja Prishtinë – Shkup, Vitinë e ndajnë vetëm 13 km rrugë. Me Prishtinën, lidhet më rrugë automobilistike në dy drejtime: përmes Ferizajt (55 km) dhe Gjilanit (67km).

Vitisë i nevojitën vetëm 13 km për t'u kyçur në hekurudhat e Kosovës, kurse deri në aeroportin e Prishtinës duhet kaluar 80 km. Me pikën kufitare me Maqedoninë, Hanin e Elezit, e ndajnë 37 km rrugë, me Shkupin 60 km, ndërkaq me aeroportin e këtij qyteti 82 km.

## Komuna e Vitisë



Vizioni i mëposhtëm për Komunën Vitisë i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna sic janë:

1. **Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2022-2024 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2022/01 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.**
2. **Plani zhvillimor i Komunës së Vitisë dhe Kllokotit ( tash Komunë e re ) 2010-2020+**
3. **Plani zhvillimor urban – Viti 2010-2015+**

***Vizioni i Komunës për tri vitet e ardhshme është një vend me plan të zhvilluar komunal dhe urban, zhvillim të qëndrushëm ekonomik, dhe shërbime efikase e kualitative, i integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër me kultura bujqësore , industri përpunuese ( drurit, metaleve ), e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe krijimit të kushteve më të mira të jetesës për qytetarët e saj.***

*Djep kulturor i shkollës shqipe, urë e zhvillimit të qëndrueshëm, modern, të fuqishëm, funksional me të gjitha përmbajtjet, komunë policentrike, atraktive për të jetuar dhe punuar, partneritetet publiko private do të determinojnë shërbimet cilësore, aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turizëm në zhvillim,Komuna e Vitisë do jetë me të gjitha resurset atraktive për investime dhe ndërmarrësi,sidomos në industrinë përpunuese, agrobiznes, turizëm kulturor e rekreativ, me theks të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm, modern, të fuqishëm, funksional me të gjitha përmbajtjet, qytet kompaktë, atraktiv për të jetuar dhe punuar, promovues i partneritetet publiko private me shërbime cilësore, aktivitete ekonomike e mirëqenie në zhvillim, me rolin dhe identitetin e fuqizuar.*

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësira e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy atribute binjake prioritet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në pesë prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Nga këto pesë prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave dhe kontribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Vitisë:

**1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë**

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimit të standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirësim, bursa për student, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë

**2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve**

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Ndihmat momentale për familjet në nevojë
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile (Caritas Kosova)

**3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij**

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimit dhe rigjenerimit të infrastrukturës rrugore (shenjëzimi i komunikacionit, ndriqimi publik dhe numerizimi), transportit, kanalizimit dhe ujit të pijshëm ,
- Përmirësimit të standardeve ambientale,
- Ofrimi i më shumë hapësirave dekorative , parqeve,
- Promovimi i projekteve për rini , sport dhe kulture.

## 4. Krijimi i siguris për qytetarët e komunës

➢ Përmirësimi i siguris në qytet dhe në tërë teritorin e komunës

Sepse komuna ka komitetin e siguris ku shqyrtohet në vazhdimësi situata e siguris

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

## 5. Funksionalizimi i qeverisjes komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar qasjen më të lehtë të tyre në administratë

Pesë fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2022-2024 do të shoqërohen me të hyra dhe shpenzime në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve përmes raporteve financiare tremujore .

### Historiku i shkurtër komunës së Vitisë në fushat :

### Zhvillimi Ekonomik

Vitia, nëpër të cilën kalon lumi Morava e Binçës, shtrihet në pjesën qendrore të fushë gropës së Moravës së Epërme. Lumi Morava e Binçës, në të cilën derdhet edhe lumi Letnica, ka një rëndësi të madhe ekonomike, meqë mundëson ujitjen e tokave. Ndonëse konsiderohet si njëra ndër komunat më të pazhvilluara të Republikës së Kosovës (me një infrastrukturë të kënaqshme rrugore, por jo edhe me rrjetin e ujësjellësit të kanalizimit ). Vitia e vendosur në një rrafshinë shumë pjellore, ka mundësinë e kultivimit të, të gjitha bimëve bujqësore. Kjo është edhe arsyeja që sektori i bujqësisë është njëri ndër sektorët kryesor të zhvillimit ekonomik të komunës së Vitisë, edhe pse viteve të pasluftës ka ngelur prapa në këtë drejtim, për të krijuar një përparësi tregtia dhe më pak zejtaria.
Sidoqoftë, Komuna e Vitisë ka potencial të madh të zhvillimit të sektorit bujqësor.

Përparësitë e komunës së Vitisë për zhvillimin e bujqësisë janë:

- Numri i madh i fermerëve dhe tradita në bujqësi
- Kualiteti i mirë i tokës bujqësore
- Rendimentet e mira në perimtari
- Ekspert të mjaftueshëm të sektorit bujqësor etj...

Duke pasur parasysh zhvillimin e bujqësisë në të ardhmen në komunën e Vitisë është hartuar një strategji për zhvillimin bujqësor që në vete ngërthen:

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore- rurale
- Projektet për ngritjen e kapaciteteve përpunuese
- Ndërrimi i metodologjisë në kultivimin e kulturave lavërtare ( grurit dhe misrit)
- Rritja e kapaciteteve të fermave ( kalimi i tyre nga fermat e vogla në ferma të mesme dhe të mëdha)

- Hapja e punkteve grumbulluese për grumbullimin e prodhimeve bujqësore (mënyrë e vetme për bujqit, për ti shitur në mënyre të sigurt prodhimet e tyre në treg).
- Ngritja e fabrikave për përpunimin e prodhimeve bujqësore
- Zhvillimi më i madh i viseve rurale në bujqësi ( ngritja e plantacioneve të pemëve)
- Ngritja e kapacitete për zhvillimin e agro-turizmit në komunën e Vitisë.
- Projektet për zhvillimin e bujqësisë organike ( nevojë dhe perspektivë e kohës)
- Menaxhimi dhe shfrytëzimi i drejtë i pyjeve, dhe
- Angazhimi i ekspertëve bujqësorë në aktivitetet e bujqësisë etj...

## Arsimi

Procesi edukativo arsimor në Komunën e Vitisë përfshinë nivelet e ndryshme si prej atij parafillor e deri te ai i mesëm e i lartë. Mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe në atë serbe dhe ka gjithsej 17 shkolla fillore me 18 paralele të ndara fizike në gjuhën shqipe dhe 3 shkolla të mesme. Gjithashtu në këtë komunë procesin mësimor e zhvillojnë edhe 1 shkollë fillore në gjuhën serbe si arsimi parashkollor- çerdhja "Gëzimi ynë " në Viti.
Në këto institucione shkollore do të vijojnë mësimin në vitin 2022 8, 005 nxënës (8, 209 në vitin 2021 çka do të thotë se kemi 204 nxënës më pak se në vitin 2021 (8.209 -8.005= 204) shih Qarkoren Buxhetore 2022/01 faqe 15) .
Më qellim të ofrimit sa më të mirë të kushteve në fushën e arsimit të kësaj komune për punë dhe për zhvillimin e procesit edukativo mësimor dhe të ngritjes së cilësisë së saj, në agjendën e Institucioneve komunale është jo vetëm përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese shkollore, por edhe ndërtimi i shkollave të reja , komuna planifikon të mbështes :

- *Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore,*
- *Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm,*
- *Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe certifikimit në sistemin .*

## Shëndetësia

Rrjeti shëndetësor në komunën e Vitisë është mjaft mirë i shpërndarë. Qytetarët e Vitisë për të marrë ndihmën dhe kujdesin primar shëndetësor, mund të drejtohen në gjashtë punkte të Mjekësisë Familjare (nëpër disa fshatra të kësaj komune), në katër qendra të mjeksis familjare ndërkohë që në qytetin e Vitisë ekziston Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Nëna Tereze", e cila për qytetarët e Vitisë ofron 24 orë shërbime.dhe ambulanta në fshatin Pozheran edhe kjo ambulant ofron 24 orë shërbime për qytetarët e Vitisë . Këto qendra e punkte, i mundësojnë Vitiasve që brenda 10-15 minutave të arrijnë deri në ambulancë ku mundë ti ofrohet kujdesi primar,shëndetësor.

**Në QKMF " Nëna Tereze"** kryhen këto shërbime:
Shërbimi i përgjithshëm
Shërbimi i mjekësisë familjare
Shërbimi ginekologjik
Shërbimi internistik
Shërbime rentgeni
Shërbimi pediatrik-
Shërbimi Stomatologjik dhe Shërbimi për vaksinim.
Kjo qendër ka rreth 139 të punësuar, ndërkaq numri 094 është gjithnjë i hapur për thirrjet emergjente.

## Kultura

**Institucioni përgjegjës për zhvillimin e jetës kulturore në komunë e Vitisë është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e cila organizohet nga këta sektor:**

- Sekori për Kulture,
- Sektori për Rini dhe Sport
- Sektori i Bibliotekës Publike Komunale
- Sektori i Arkivit Historik

Organizimet kulturo-sportive Statutare në kuadër të kësaj drejtorie janë:

- "Flakadani i Karadakut", 21-26 Mars
- "2 Korriku"- 18 Qershor- 2 Korrik

- Dita e çlirimit e Komunës së Vitisë, 14 Qershor
- 5 Maji, Dita e Dëshmorëve të Atdheut

Ndërkaq manifestimi kulturor, letrar e shkencor " Takimet e Dom Mikelit" është një manifestim tradicional me përmasa gjithëkombëtare. Ky manifestim organizohet nga Shoqata e Kulturore Shkencore "Dom Mikel Tarabulluzi" me qendër në fshatin Stubëll. Ky manifestim tradicional organizohet që nga viti 1990 dhe mbahet zakonisht të premten dhe të shtunën e parafundit të muajit shtator, në shenjë të shënimit të Shkollës së parë shqipe në Kosovë, më saktësisht në fshatin Stubëll 1584-1905 dhe në shenjë të përkujtimit të mësuesit të saj Dom Mikel Tarabulluzit, ndër aktivitete tjera të cilat organizohen apo mbështeten nga DKRS tradicionalisht janë: Ditët e Zojes së Bekuar, 17 Shkurti-Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, 3 Maji-Dita Botërore e Lirisë së Shtypit, 9 Maji- Dita e Evropës, 1 Qershori- Dita Ndërkombëtare e Femijëve, 15 Shtatori- Dita Ndërkombëtare e Demokracisë, 26 Nëntori- American Thanksgiving, 28 Nëntori- Dita e Flamurit Kombëtar, 8 Marsi- Dita Ndërkombëtare e Gruas, 7 Marsi- Dita e Mësuesit ndërsa nga kodi buxhetor i DKRS-se gjate vitit fiscal shpërndahen subvencionet sipas kërkesave.

Në kuadër të bibliotekës komunale të Vitisë ekziston një fond librash prej 54.556 dhe atë në gjuhët: shqipe, serbokroate, angleze, frënge e turke). Në kuadër të kësaj biblioteke funksionon sektori për të rritur dhe të vegjël gjithashtu përveç fondit të librave tekstual kjo bibliotekë ka edhe fondin auditiv (për të verbër) por ky fond është vetëm në gjuhën angleze. Numri i lexuesve është gjithnjë në rritje dhe ky numër është afër 10.000,. Kjo bibliotekë është e vendosur në Shtëpinë e Kulturës "Bajram e Gursel Sylejmani" në Viti dhe gjithashtu në kuadër saj funksionon biblioteka në : Pozheran, dhe Sllatinë e Epërme.

# III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve ( KASH-Qarkorja buxhetore ) 2022-2024 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike sic janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe domografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2022-2024 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike dhe sociale të vendit .

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale, rritjes reale duke pasur parasysh mbledhjen e të hyrave vetanake duke pasur parasysh situatën e sëmundjes së pandemis që do të kemi efekt negativ të mbledhjes së të hyrave si nga niveli qëndror por në veçanti në nivelin lokal (THV-Komunale) .

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Grantet qeveritar dhe 2. Të Hyrat Vetanake**

### 3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2022-2024

Buxheti i Komunës së Vitisë përbëhen nga dy burime kryesore.

1. **Grantet qeveritare dhe**
2. **Të hyrat vetanake komunale .**

Figura 1: Buxheti i Komunës në vite (2020 – 2024), milion Euro:,




Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2021 buxheti për Komunën e Vitisë si tërësi do të shënojnë rritje 4.63%. Buxheti në vitin 2020 ishte në shumë prej 12,305,491 € , vitin 2021 është në shumë prej 12,490,686 € , vitin 2022 është 13,069,494 € , në vitin 2023 prej 13,721,277 €, në vitin 2024 prej 14,393,158 €, ) sipas të dhënave të prezantuara në tabelën më poshtë, këto të dhëna kryesisht bazohen në të dhënat e përgjithshme buxhetore që planifikohen në nivel të Qeverisë nacionale, sic parashihet me KASH-in 2022-2024. Rritja për vitin 2022 kryesisht është reflektuar në grantin e përgjithshëm në vlerë prej 274,317 € ( 5.99%), grantin specifik të arsimit

në shumë prej 177,873 € ( 3.28%) , në grantin e shëndetësis është vlera e njëjt dhe të hyrat vetanake kanë rritje në vlerë prej 126,618 € (14.70%).

Në vitin 2022 kemi rritje në total të dy grantet operative ( granti i përgjithshëm, dhe granti specifik i arsimit) në shumë prej 452,190 € kurse granti spefifik i shëndetsis mbetet i njëjt me vitin 2022 .

Të hyrat vetanake komunale në krahasim me vitin 2021 në vitin 2022 kanë rritje në vlerë prej 126,618, janë të planifikuara në vlerë prej 987,868 €, po ashtu në vitin 2023 janë të planifikuara në vlerë prej 1,063,636 €, për vitin 2024 janë prej 1,112,613 € ( kufijt e caktuar nga komisioni i granteve në nivel ndërqeveritar Qarkore buxhetore e komunave 2022/01).

Tabela 2: Planifikimi i të hyrave komunale sipas burimit për vitet 2021-2024

| | Komuna: Viti | Grantet dhe THV - 2021 | Grantet dhe THV 2022 | Grantet dhe THV 2023 | Grantet dhe THV 2024 |
|---|---|---|---|---|---|
| | | në Euro | në Euro | në Euro | në Euro |
| | Burimet e të Ardhurave | | | | |
| 0 | GRANTET | 10,243,809 | 11,356,893 | 11,356,893 | 11,715,083 |
| 1. | Granti i Përgjithshëm | 4,575,868 | 4,850,185 | 5,064,629 | 5,307,882 |
| 2. | Granti i Arsimit | 5,425,184 | 5,603,057 | 5,883,209 | 6,177,370 |
| 3. | Granti i Shëndetësisë | 1,628,384 | 1,628,384 | 1,709,803 | 1,795,293 |
| | TOTALI I TË HYRAVE KOMUNALE | 861,250 | 987,868 | 1,063,636 | 1,112,613 |
| | TOTAL BUXHETI PËR VITE | **12,490,686** | **13,069,494** | **13,721,277** | **14,393,158** |
| I-A. | **TË ARDHURAT E ADMINISTRATËS KOMUNALE - Direkte** | | | | |
| Nr | **Burimet e të Ardhurave** | **Viti 2021** | **Viti 2022** | **Viti 2023** | **Viti 2024** |
| 1 | Sherbimi i arhivit | 3,600 | 1,500 | 1,700 | 1,700 |
| 2 | Dokumentet zyrtare ofiqarija(qertifikatat e lindjes) | 2,000 | 3,960 | 5,000 | 5,000 |
| 3 | Kunorëzimi | 9,600 | 3,960 | 4,000 | 4,000 |
| 4 | T.H. tjera ofiqarije | 43,979 | 45,600 | 48,000 | 48,000 |
| | **Totali i Administrates** | **61,200** | **55,020** | **58,700** | **58,700** |
| 1 | Qiraja nga hapsira publike | 13,548 | 14,138 | 14,138 | 14,138 |
| 2 | Shfrytëzimi i hapësirës publike | 3,600 | 7,482 | 8,400 | 7,410 |
| 3 | Reklamat | 4,200 | 3,200 | 4,000 | 4,000 |
| 4 | Parkim publik | 7,700 | 6,535 | 7,700 | 6,000 |
| 5 | Taksë për licenca autotaksive | 3,000 | 2,000 | 2,410 | 2,000 |
| | **Totali i Sherbimeve Publike** | **32,048** | **33,355** | **36,648** | **33,548** |
| 1 | Lejet e Ndertimit | 54,000 | 49,473 | 70,000 | 66,965 |
| 2 | Lejet mjedisore | 5,800 | 5,800 | 7,200 | 5,000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Lejet e perdorimit | 2,400 | 2,400 | 2,500 | 2,500 |
| | **Tot.Urbanizmit** | **62,200** | **57,673** | **79,700** | **74,465** |
| 1 | Tatimi në prone/ tokë | 439,589 | 592,320 | 600,655 | 666,000 |
| 2 | Rexhistrimi i automjeteve | 80,000 | 80,000 | 90,000 | 85,000 |
| | **Tot.Ekonomi, Financa** | **519,589** | **672,320** | **690,655** | **751,000** |
| 1 | Fleta poseduese dhe kopje plani | 24,900 | 24,900 | 25,000 | 25,000 |
| 2 | Bartja e pronësisë | 30,700 | 20,500 | 31,000 | 31,000 |
| 3 | Daljet në teren | 18,600 | 12,000 | 14,000 | 14,000 |
| | **Totali Kadastër- gjeodezi** | **74,200** | **57,400** | **70,000** | **70,000** |
| 1 | Participim nështëndetësia | 60,000 | 55,000 | 60,000 | 60,000 |
| 2 | Të hyrat nga qiraja - ob.she. | 8,640 | 8,640 | 9,178 | 9,000 |
| 3 | Vërtetime nga QPS-ja | 1,200 | 1,200 | 3,500 | 3,500 |
| | **Tot.Shendetesi** | **69,840** | **64,840** | **72,678** | **72,500** |
| 1 | Të hyrat nga qerdhja | 18,000 | 28,800 | 30,000 | 30,000 |
| 2 | Të hyrat nga shkollat e mesme | 2,400 | 720 | 2,500 | 2,500 |
| | **total.Arsimit** | **20,400** | **29,520** | **32,500** | **32,500** |
| 1 | Të hyrat nga sht.kultures | 600 | 600 | 1,100 | 1,000 |
| 2 | Te hyrat nga arhivi historik | 600 | 600 | 1,100 | 1,000 |
| | **Totali i Kultures** | **1,200** | **1,200** | **2,200** | **2,000** |
| 1 | Shitja e masës drurore | 2,400 | 2,200 | 2,400 | 2 400 |
| 2 | Shenderrimi i tokes buj.-nde. | 6,773 | 5,460 | 6,000 | 6,000 |
| 3 | Vertetimi per marrje me veprimtari bujqesor | 1,800 | 1,800 | 2,000 | 2,000 |
| | **Totali i Bujqesise** | **10,973** | **9,460** | **10,400** | **8,000** |
| 1 | Inspektimi i tregut | 2,400 | 600 | 1,000 | 1,000 |
| 2 | Gjobat nga inspekcioni | 2,400 | 480 | 755 | 700 |
| 3 | Shiqimi i autotaksive | 1,200 | 1,200 | 1,200 | 1,200 |
| 4 | Pranimi teknik i lokaleve | 2,400 | 4,440 | 6,000 | 6,000 |
| 5 | Inspektimi sanitar | 1,200 | 360 | 1,200 | 1,000 |
| | **Totali i Inspeksionit** | **9,600** | **7,080** | **10,155** | **9,900** |
| | **Totali** | **861,250** | **987,868** | **1,063,636** | **1,112,613** |

Në planifikimin e buxhetit nuk kalkulohen të hyrat e nivelit qëndror - të hyrat indirekte por vetëm të hyrat direkte .

Buxheti komunal vazhdon të dominohet nga transferet qeveritare në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 92.44 % (12,081,626 € ) të buxhetit total të komunës kurse nga të hyrat vetanake të komunës me 7.56 % ( 987,868 €) .

| | Shuma në € | në % |
|---|---|---|
| Transferet qeveritare/grantet | 12.081,626 | 92,44 |
| Të hyrat vetanake Komunale | 987.868 | 7,56 |
| Totali | 13.069,494 | 100,00 |

## 3.3 Politikat e reja

**Së pari** , Komuna e Vitisë në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adaptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuara në nivelin e qeverisë komunale.

Me këtë Qarkore përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2022 dhe orientimet për vitet 2023-2024, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, kjo Qarkore përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2022 si dhe parashikimin afatmesëm 2023-2024.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2022, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Komisioni i Granteve në kuadër të MFT ka aprovuar financimin komunal për vitin 2022 dhe projeksionet për vitin 2023-2024.

**Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:**

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Prezentimi i struktures së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2022 dhe projekcionet e vitit 2023 dhe 2024.

Komunat janë të obliguara të përgatisin Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2022-2024, dhe të aprovojnë në Kuvendin Komunal deri me datë 30.06.2021 si dokument strategjik komunal, i cili dokument bazohet në synimet dhe objektivat të orientuara në rezultate si dhe pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.

Ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2022-2024, sygjerimet të Qeverisë së Kosovës janë që shuma e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është nën dhjetë përqind e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore , (duke përjashtuar mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë dhe tokë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat tjera të qeveris lokale. Bazuar në tabelën nr të qarkores buxhetore 2022/01 të përgaditur nga Departamenti i politikave ekonomike, publike dhe bashkëpunimit ndërkombëtar financiar të ministris së financave në përputhje me LFPL, granti i përgjithshëm për komuna për vitin 2022 është aprovuar nga komisioni i granteve në shumë prej 193.53 milion €. Kjo ndarje bazohet në formulen e përcaktuar nga neni 24 të LFPL , sipas këtij neni 10% e të hyrave totale të buxhetuara të

qeveris qëndrore ju ndahen komunave duke përjashtuar mbështetjen buxhetore dhe grantet , te hyrat nga tatimi në pronë e tokë, interesi, taksat, dhe të hyrat vetanake të komunave( shih QB2022/01 faqe 10).

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë duke zbritur nga 1 euro për kokë banori . Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS në komuna duhet të financohet nga granti i përgjithshëm komunal. Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim arauniversitar dhe Shëndetësi primare financohen nga granti i përgjithshëm në komuna. Po ashtu, nga granti i përgjithshëm do të plotësohen edhe grantet specifike për arsim para universitar dhe shëndetësi primare kur është e nevojshme.

**Projeksionet e bëra për vitin 2022 dhe vlerësimet për vitin 2023 dhe 2024 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, reflektojnë rritje të grantit qeveritar në bazë të qarkores buxhetore 2022/01 në këto grante si :**

1. **Granti i përgjithshëm shuma e rritje nga viti 2021 në vitin 2022 në shumë prej 274,317 €,**
2. **Granti specifik i arsimit shuma e rritjes për 177,873 €,**
3. **Granti specifik i shëndetsisë (vetëm për kujdesin primar shëndetësor) shuma ebarabart me vitin 2021.**

**Totali i rritjes së granteve është në shumë prej 452,190 €.**

**Shuma e të hyrave vetanake është e rritun nga viti 2021 prej 126,618 €.**

**Së dyti,** komuna e Vitisë ka rritje të granteve (452,190 €.), arësyeja është rritja e vogël e këtij granti në nivel vendi në 196.28 milion € (në vitin 2021 në milion 182.58 € në vitin 2021 shih QB 2022/01 faqe 11 ), implementimi i ndryshimeve ligjore të cilat bartin kosto shtesë të shpenzimeve , implementimi i pjesës së kontratës kolektive që ndërlidhet me përvojën e punës si dhe pagesa e tri pagave jubilare pas pensionimit të punëtorëve arsimor sipas kontratës për arsim .

**Së treti,** në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shteterore të ndarjes së grantit të arsimit për Komuna, ndarje kjo që është bërë në qarkoren buxhetore 2022/01 në bazë të numrit të nxënësve ( për komunën tonë prej 8,005 (8,209 - 8,005 = 204 ) në vitin 2022 çka do të thotë se kemi 204 nxënës më pak se në vitin 2021 , do të thotë se nga viti i kaluar kemi numër në planifikimin e buxhetit më pak për 204 nxënës), atëherë kjo do të ketë ndikim në buxhetin e Komunës.

Financimi i programit të administratës së arsimit, administratës së shëndetësis dhe shërbimeve sociale bëhet nga granti i përgjithshëm .

Grantin specifik për arsim parauniversitar për vitin 2021 është aprovuar në shumë prej 194.8 milion euro, nga të cilat 175.5 milion euro janë paga dhe mëditje, 14 milion euro janë mallra dhe shërbime dhe 2.5 milion euro hpenzime kapitale.

Granti Specifik për Arsim sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit parauniversitar të MASHT për vitin 2022.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kritere:

a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2020/2021;

b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.22/2013 të MASHT);

c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;

d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;

e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;

f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;

g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;

h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;

i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm

j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);

k) Kalkukimi I pagave dhe shtesave është bazuar në pagën mesatare aktuale në arsimin parauniverzitar

l) Shërbimi professional pedagogjik/psikologjik;

m) Koordinatorët e cilësisë;

n) Kalkulimi i pagave për zavendësimeve gjatë pushimeve të lehonisë 6%;

o) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);

p) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;

q) Kalkulimi i tri pagave pas pensionimit me kosto prej 1.5 milion euro;

r) Paga për asistent për fëmijë me nevoja të veçanta me kosto prej 0.78 milion euro;

s) praktika pofesionale me kosto 3.5 milion €:

t) pagat jubilare sipas kontratës kolektive për arsim me kosto prej 1.25 milion €:

u) pagat për parafillor për shkolla 2-5 vjeç me costo prej 1.9 milion €;

v) mallra e shërbime për fëmij prej 4-5 vjeç me kosto prej 78,848 €

w) Kosto e pagesës së procedurave për validitim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale ( 8 Shkolla me kosto prej 38.400 €).

**Sipas MASHT është raportuar numri për 11,083 nxënës më pak në arsim parauniversitar krahasuar me vitin paraprak . Duke u bazuar në zvogëlimin e vazhdueshëm të numrit të nxënësve nga viti në vit dhe duke marrë për bazë parametrat mësimdhënës/nxënës sipas gjendjes aktuale, MASHT rekomandon komunat se me rastin e e pensionimit të stafit mësimdhënës mos të shpallin konkurs për pranimin e kuadrit të ri, por të sistemojnë mësimdhënësit të cilët nuk kanë normë ose nuk kanë normë të plotë.**

**Së katërti**, Komuna e Vitisë ndonëse me informata të limituara do të jetë e ndikuar në aspektin buxhetor edhe me rastin e fillimit të aplikimit të Ligjit për gradim në paga që QB 2021/01 përfshinë të gjitha kategoritë e shpenzimeve, me përjashtim të pagave dhe mëditjeve. Kjo është për arsye se siç jeni të informuar kohë më pare në Kuvend është miratuar ligji I pagave ( Reformës së Administratës Publike) mirëpo ky ligj ende nuk ka hyrë në zbatim por në qarkoret pasuese do të njoftoheni lidhur me kufirin në paga,, ndonëse ende nuk është bërë ndonjë analizë në lidhje me ndikimin fiskal apo buxhetin e Komunës. Komuna nuk posedon me informatat e nevojshme të kostos së gradimit të punëtorëve komunal dhe do të kem një ndryshim të kostos së kalkuluar të pagave të tanishme ,

saktësia e nivelit të pagave përcaktohet me rastin e aplikimit të pagave me gradimin e pagave dhe presim në qarkoren e dytë apo tretë .

**Së pesti**, Komuna e Vitisë do të mirëpriste deklarimet e Qeverisë Nacionale, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike përveç pagave e mëditjeve dhe subvencioneve, shpenzimeve kapitale të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake (THV), sërish qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes eventualisht eleminimit të atyre taksa e ngarkesa komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal, janë jo transparente dhe fer, karshi qytetarëve respektivisht tatimpaguesit komunal.

Duke u bazuar në analizën e të hyrave të tatimit në pronë dhe tokë, ngarkesës tatimore dhe të paarkëtueshmëve kemi pasur rezultat negativ në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 në shumë prej 98,654.19 € do të thotë se situata e pandemis Covid -19 ndikoi në mos realizimin e THV-ve, kemi rritje të inkasimit por duhet të merren masa të tjera të rritjes së shumës së arkëtimit të këtij tatimi që % e të hyrave të jetë shumë ma e madhe duke u mobilizuar me forma tjera të vetëdijësimit të qytetarëve për shlyerjen e borxheve .

Tabela 3: Shuma e tatimit në pronë dhe tokë e vlerësuar për 2021, me normat aktuale tatimore.

| Komuna | Numri i faturave tatimore | Shuma aktualisht e vlerësuar tatimore | Fatura mesatare aktuale |
|---|---|---|---|
| Viti | 11,235 | 545,001 € | 48.50 € |

